

Testo originale: Fatos Lubonja, Ridënimi, Përpjekja, 1996, 88 pp.

U ktheva në qeli me përshtypjen se ballafaqimi kishte qënë një formalitet kurse mohimi im krejt i papërfillshëm. Pastaj mbeta duke peshuar faktin se të tre lakandarët që erdhën e shpifën aq paturpësisht ishin djem të rinj, të fuqishëm fizikisht, me ndihma nga familja dhe me një farë edukate dhe niveli kulturor. Nuk arrija ta gjeja deri në fund se çfarë mungese në karakter i lejonte të shpifnin në atë mënyrë. Mungesa e ndenjës së turpër, po çfarë ishte kjo? Ndoshta mungesa e kujtesës morale, një gjendje e afërt me atë të kafshës e cila ndjek vetëm të mirën e atypëratyshme dhe, me sa duket, njeriu në moshë të re ishte më afër kësaj gjendjeje. Mirëpo më dilnin parasysht mjaft bashkëmoshatarë të tyre tepër krenarë e idealistë, të cilët bënin punët më të rënda në minierë pa iu trembur as galerisë as policisë, madje me prirjen për t'i sfiduar ato. Pastaj kujtoja disa pleq në kamp që ishin po aq të poshtër sa këta, në mos edhe më. Atëherë më dukej se ndryshimi qëndronte në raportet që kishin njerëzit me autoritetin, pavarësisht nga mosha. Pikërisht ata që ligeshin e i nënshtroheshin hijes së autoritetit, shërbenin tani në këtë mënyrë. Por edhe kjo s'qëndronte. Kishte të tjerë të burgosur në kamp, të urtë e të nënshtuar, por që s'merreshin me kesi punësh të ndyra. Soji i Grigorit ishte njëherësh agresiv dhe i paturpshëm deri në krim si dhe servil e i nënshtuar përsëri deri në krim. Sidoqoftë një gjë vija re. Sa më shumë u kalonte mosha aq më shumë këta soj njerëzish e ulnin agresivitetin duke u bërë gjithnjë e më të matur e me të fshehtë në punët e ulta.